

## Abstrakti

Zhvillimet dinamike shoqërore në shekullin XXI kërkojnë reagimin dhe përshtatjen edhe në fushën e aviacionit civil. Rritja e ndërvarësisë më mes shteteve ka ndikuar në shtimin e lëvizjeve të njerëzve dhe kapitalit dhe rrjedhimisht ka shkaktuar nevojën për shtimin e numrit të personave që udhëtojnë si për qëllime private ashtu edhe për qëllime biznesi. Kjo rritje kërkon ndryshime si në aspektin logjistik ashtu edhe në aspektin ligjor.

Industria e aviacionit civil në rrafshin e kompensimit të dëmit është e rregulluar mbi dokumentin bazë të njohur si Konventa e Montrealit e vitit 1999 e cila shërben si akt më i lartë juridik për vendet të cilat e kanë ratifikuar. Mbi bazën e këtij dokumenti është ngritur struktura legjislativë e vendeve ratifikuese të cilat me akte ligjore dhe nënligjore inkorporuan normat dhe parimet e vendosura nga kjo konventë.

Zhvillimet me një dinamikë të përshpejtuar historikisht kanë treguar se kërkojnë ndryshime dhe përshtatje edhe në fushën ligjore, pra në përshtatjen dhe ndryshimin e kuadrit ligjor rrethanave të reja të krijuara. Duke u mbështetur në këtë konsideroj se vitet e ardhshme do të jenë sfiduese për shoqërinë në përshtatje të këtyre ndryshimeve prandaj ndryshimet dhe inovacionet që kërkohen sidomos në implementimin më efikas të normave mbi bazën e të cilave burojnë të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të fushës së aviacionit civil janë të domosdoshme.

**Fjalët kyçe:** *Kompensimi i dëmit, aviacion civil, transpozim, aksident, rrethanë e jashtëzakonshme, anulim, refuzim i imbarkimit, vonesë e fluturimit.*

## **Abstract**

Dynamic social developments in the 21st century require response and adaptation in the field of civil aviation as well. The increase in interdependence between countries has influenced the increase in the movement of people and capital and consequently has caused the need to increase the number of people who travel both for private purposes and for business purposes. This increase requires changes in both logistical and legal aspects.

The civil aviation industry in terms of compensation for damage is regulated by the basic document known as the Montreal Convention of 1999, which serves as the highest legal act for countries that have ratified it. On the basis of this document, the legislative structure of the ratifying countries was established, which incorporated the norms and principles established by this convention with legal and by-laws.

Developments with an accelerated dynamic have historically shown that they require changes and adaptation in the legal field, that is, in the adaptation and change of the legal framework to the newly created circumstances. Based on this, I consider that the coming years will be challenging for society in adapting to these changes, therefore the changes and innovations that are required especially in the more efficient implementation of the norms on the basis of which the rights and obligations of the subjects of the aviation field originate civil are necessary.